



Здружение на финансиски работници
на локалните самоуправи и јавните претпријатија

Association of finance officers
of the local governments and public enterprises



Пërshkrim i përgjithshëm për realizimin e detyrave për Ekspertin - Tipi A
për përgatitjen e Vlerësimeve PEFA në 10 komuna

Projekti

"Fuqizimi i Këshillave Komunale - Faza 2", financuar nga Qeveria Zvicerane, Ministria e Vetëqeverisjes
Lokale, dhe bashkëfinancuar e zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara - UNDP

Mars, 2026.



1. Sfondi

Shoqata e Punonjësve Financiarë të Vetëqeverisjes Lokale dhe Ndërmarrjeve Publike (ZFR) merr pjesë në zbatimin e aktiviteteve të projektit "Fuqizimi i Këshillave Komunale - Faza 2", (Empowering Municipal Councils – Phase 2), financuar nga Qeveria Zvicerane, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, dhe bashkëfinancuar e zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara - UNDP.

Projekti ka për qëllim të vazhdojnë aktivitetet e nisura më parë për fuqizimin e komunave përmes këshillave komunale të fuqizuara, të cilat janë në gjendje të përmbushin në mënyrë efektive rolet e tyre të caktuara të përfaqësimit, mbikëqyrjes dhe respektimit të legjislacionit komunal, me përfshirjen aktive të qytetarëve.

Shoqata e Punonjësve Financiarë po e zbaton programin për zhvillimin e kapaciteteve të komunave dhe do të kontribuojë në përdorimin më të gjerë të veglave të mësuarjes nga këshilltarët komunal, administrata komunale dhe kryetarët e komunave. Përveç kësaj, Shoqata e Punonjësve Financiarë (ZFR) u ofron mbështetje të ekspertëve për komunat në proceset e prokurimit që lidhen me grantet për projekte me interes publik të komuniteteve lokale.

Aktivitetet e ZFR dhe ekspertët e angazhuar janë të fokusuar në zbatimin e aktiviteteve

1: Përmirësimi dhe ofrimi i programit për zhvillimin e kapaciteteve, që është pjesë e rezultatit të parë projektues.

2. Rezultatet e pritura dhe rezultatet e projektit

Faza e dytë e projektit "Fuqizimi i Këshillave Komunalë" është strukturuar rreth rezultateve të mëposhtme::

Rezultati 1: Performancë e përmirësuar në mënyrë sistematike dhe të qëndrueshme e këshillave komunalë, sistem i fuqizuar dhe i përmirësuar i qeverisjes lokale.

Rezultati 2: Pjesëmarrja e qytetarëve është fuqizuar për të ruajtur demokracinë lokale dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës të grave dhe burrave.

Rezultati 3: Shërbime të përmirësuara komunale përmes ngritjes së teknologjisë dhe inovacioneve.

3. Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të ekspertëve në zbatimin e aktivitetit "Përgatitja e Vlerësimit PEFA"

Ekspertët që do të angazhohen për aktivitetin "Përgatitja e Vlerësimit PEFA të dhjetë komunave partnere të përfshira në projektin "Fuqizimi i Këshillave Komunale - Faza 2", do të kenë detyrim që t'i realizojnë (të marrin pjesë në realizimin e) aktiviteteve të mëposhtme:

Përshkrimi i detyrave të punës
Takime Koordinuese të Ekipit PEFA (para fillimit të hulumtimit)
Përshtatja e Modelit PEFA
Përgatitja e materialeve të hulumtimit
Intervista / Vizita në Terren për PEFA në 10 komuna
Përpunimi i materialeve dhe informacioneve të hulumtimit
Përgatitja e një draft versioni të hulumtimit për 10 komuna
Takim koordinues për të shqyrtuar Draft versionet dhe për të përcaktuar versionet përfundimtare të hulumtimeve për 10 komuna
Përgatitja e versioneve përfundimtare të hulumtimeve
Përgatitja e një raporti integral
Përgatitja e raporteve krahasuese



Здружение на финансиски работници

на локалните самоуправи и јавните претпријатија

Association of finance officers
of the local governments and public enterprises



Експертët e пërzgjedhur do të lidhin marrëveshje individuale kornizë për kohëzgjatjen e Vlerësimeve PEFA në vitin 2026, pra për periudhën Mars-Qershor 2026. Në marrëveshjet individuale do të specifikohen të gjitha detajet që lidhen me zbatimin e aktiviteteve. Експертët e пërzgjedhur do të duhet gjithashtu të nënshkruajnë një deklaratë disponueshmërie.

Vlerësimi i PEFA-s do të zbatohet në dhjetë komunat partnere në vijim: Negotinë, Prilep, Debërcë, Kriva Pallankë, Shtip, Novosellë, Aerodrom, Haraçinë, Karposh, Bogovinë.